



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 18 tetor 2013

Nr.ref.:RK482/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI36/13

Parashtruesi

Mursel Kosumi

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 120/2012,
të 29 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtrues

1. Parashtrues është Mursel Kosumi, me vendbanim në Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 120/2012, të 29 nëntorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i lartpërmendur i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, gjegjësisht nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56, paragrafi 2, i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 mars 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 25 mars 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrties në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 29 mars 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme, e cila deri më tanë nuk ka dorëzuar asnje koment.
8. Më 12 shtator 2013, Kolegji shqyrties shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

9. Nga shkresat e lëndës del që më ose rrëth 9 gushtit 2011, parashtruesi i kërkesës e njoftoi FB-në me BB-në, nga kompania ndërtimore përfurnizim NTP "Zhitija Com" të Obiliqit. Parashtruesi pretendon, ose mbështet pretendimin, se FB-ja ishte një banor i huaj dhe pronar i një hoteli në Podujevë dhe se FB-ja dëshironë të blejë kubëza betoni përfshtrim përfshrimin e hotelin e tij.
10. Më 9 gusht 2011, FB-ja kishte nënshkruar kontratën me BB-në përfshrimin e 1,500 metrave katrorë të kubëzave të betonit, me çmim të përgjithshëm prej 9,000 eurosh. Parashtruesi i kishte dhënë BB-së një garanci verbale përfshrimin e çmimit të blerjes në rast se FB-ja do të dështonte që të paguajë. BB-ja kishte bërë biznes më parë me parashtruesin dhe prandaj u kishte besuar fjalëve së tij.

11. Kubëzat e betonit i ishin dorëzuar më pas parashtruesit, i cili i ka përdorur ato për ta shtruar tokën rreth hotelit dhe shtëpisë në pronësi të MI-së nga Podujeva. Shtrimi i tokës përreth hotelit me kubëza betoni ishte rezultat i një marrëveshjeje të mëhershme në mes të parashtruesit dhe MI-së, dhe ishte menduar si kompensim për transferimin e gjashtë automjeteve te parashtruesi, të cilat i përkasin MI-së, në një vlerë prej 11,600 eurosh.
12. Më 26 gusht 2011, FB-ja iu drejtua BB-së me një kërkesë për të blerë një ekskavator. BB-ja pyeti parashtruesin e kërkesës nëse FB-së mund t'i besohet për pagesë, dhe me sa duket parashtruesi i është përgjigjur se FB-ja kishte para dhe do të paguante. BB-ja kishte nënshkruar një kontratë me FB-në për blerjen e një ekskavatori me një çmim prej 12.000 eurosh. Atëherë, FB-ja kishte paguar një shumë fillestare prej 2.000 eurosh dhe kishte marrë në dorëzim ekskavatorin.
13. Më 4 shtator 2011, FB-ja ia kishte shitur ekskavatorin kompanisë së hekurishteve në Fushë-Kosovë për 4.200 euro.
14. Në një fazë të caktuar, BB-ja e pyeti parashtruesin e kërkesës, kur do të paguhej për kubëzat e betonit. Pretendohet se parashtruesi i kërkesës i është përgjigjur se FB-ja e kishte lëshuar vendin. BB-ja pastaj shkoi për të vizituar vendin ku ishin dorëzuar kubëzat e çimentos. Atje, ai u takua me MI-në dhe zbuloi se FB-ja nuk ishte pronar i një hoteli. Në këtë moment, BB-ja pretendohet të ketë raportuar parashtruesin dhe FB-në tek autoritetet e duhura, duke i akuzuar ata për mashtrim.
15. Më 29 shtator 2011, Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë e dorëzoi një aktakuzë kundër parashtruesit dhe FB-së si bashkëkryerës të veprës penale të mashtrimit.
16. Më 14 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë e konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesit.
17. Më 5 dhjetor 2011, Gjykata Komunale e Prishtinës (P. nr. 2840/11) e dënoi parashtruesin si bashkëkryes të veprës penale të mashtrimit. Parashtruesi u dënuia me një (1) vit burgim, por përmbarimi i këtij dënimis u pezullua me kusht që parashtruesi t'ia paguajë shumën prej 9,000 eurosh viktimës (BB) brenda gjashtë muajve pasi ky vendim të bëhet i formës së prerë dhe me kusht që parashtruesi mos të kryejë ndonjë veprë të re penale brenda dy (2) vitesh nga dita kur ky vendim merr formë të prerë.
18. Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ankesa pretendonte se gjykata e shkallës së parë kishte kryer shkelje materiale të ligjit, *inter alia*, në lidhje me veprën penale, dhe nuk i kishte përcaktuar saktë faktet. Parashtruesi pretendonte se ai kishte qenë i angazhuar në transaksionet e rregullta afariste dhe nuk kishte pasur synimin e qëllimshëm për të kryer mashtrim. Ai gjithashtu pohoi se ai nuk kishte përfituar nga mashtrimi i pretenduar.
19. Në mbështetje të ankesës së tij, parashtruesi paraqiti prova të reja, përkatesisht një kontratë të nënshkruar më 10 gusht 2011, midis atij dhe të bashkakuzuarit

FB. Kjo kontratë parashikon që parashtruesi posedon pesë (5) automjete, të cilat do të jepen në këmbim të 1.500 metrave katrorë të kubëzave të betonit, të poseduara nga FB-ja. Marrëveshja është shoqëruar nga një deklaratë e nënshkruar nga FB-ja më 20 dhjetor 2011. Kjo deklaratë thekson se vlera e sendeve të shkëmbyera është vlerësuar bashkërisht në vlerë prej 9,000 eurosh dhe se kushtet e marrëveshjes janë përbushur në mënyrë të plotë nga palët. Edhe kontrata, edhe deklarata ishin të dëshmuara nga një avokat.

20. Më 10 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (AP. nr. 15/2012) e shpalli ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi në tërësi vendimin e Gjykatës Komunale (P. nr. 2840/11) për dënim dhe burgim. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të dispozitave të ligjit penal, Gjykata deklaroi:

[...] Aktgjykimi i kundërshtuar është konkret dhe i qartë, nuk ka kundërthënie me vetveten, e as me arsyet e paraqitura në aktgjykimin e kundërshtuar. [...] gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të mbështetur [nga kjo gjykatë] dhe ka dhënë arsyet e qarta dhe bindëse për vërtetimin e tillë të fakteve, ka dhënë vlerësimin për provat e administruara duke arsyetuar se pse disa fakte i merr të vërtetuara, ka vlerësuar argumentet e të akuzuarit dhe pastaj e ka arsyetuar qartë se për çfarë arsyet e pranon versionin e mbrojtjes së tyre dhe këtë arsyetim e mbështet edhe kjo gjykatë. [...]

Duke e vlerësuar edhe bazën ankimore [të akuzuarit] se në aktgjykimin e kundërshtuar është bërë vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, sipas vlerësimit të kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk janë të bazuara. Qasja e gjykatës së shkallës së parë ndaj provave të administruara, pra edhe ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, prandaj një qëndrim të tillë e mbështet edhe kjo gjykatë. [...]

21. Parashtruesi paraqiti kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale (P. nr. 2840/11) dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut (AP. nr. 15/2012). Parashtruesi kishte pretenduar, *inter alia*, se vendimet e gjykatave të instancës së parë dhe të dytë i kishin shkelur dispozitat materiale të kodit penal. Në veçanti, parashtruesi pretendonte se Gjykata e Qarkut kishte dështuar t'i marrë parasysh provat e reja që ai i kishte paraqitur dhe të cilat dëshmonin pafajësinë e tij.
22. Më 29 nëntor 2012, Gjykata Supreme (Pkl. nr. 120/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme konsideronte se kërkesa nuk kishte paraqitur arsyet për të mbështetur pretendimin e tij për shkeljen e dispozitave të ligjit penal, por në vend të kësaj, gjeti se “[...] teksti i tërësishëm i kërkesës është më shumë i orientuar në lidhje me segmentet e fakteve se pala e gjykuar nuk ka ndërmarrë asnje veprim për ta mashtruar palën e dëmtuar.”

23. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme theksoi:

“Në këtë çështje penalo-juridike, gjykata e shkallës së parë, e po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vlerësuar të gjitha veprimet inkriminuese të të gjykuarit dhe drejt kanë vlerësuar se në veprimet e tij formësohen elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, e që si të drejta dhe të bazuara i pranon edhe kjo gjykatë. Elementi i dashjes në veprimet e të gjykuarit manifestohet se tanë i gjykuari [pala] [...], me marrëveshje paraprake është pajtuar që ta vërë në lajthitje dhe duke e shtyrë që të veprojë në dëm të pasurisë së tij [palen e dëmtuar], duke e paraqitur rrejshëm FB-në si pronar të një hoteli, i cili duke i besuar ... [palës së gjykuar], të cilin më parë e ka njojur, lidh kontratë me FB-në për shitjen e kubëzave të betonit në sasi prej 1,500 m² (një mijë e pesëqind metra katrorë) në vlerë prej 9.000€, e të cilat kubëza [pala e gjykuar] i shtron te hoteli i MI-së dhe për këtë lidh kontratë me MI-në për blerjen e gjashtë veturave në vlerë prej 11.6000 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro), me ç'rast i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit[palës] në vlerë prej 9.0000 (nëntë mijë eurosh).

Gjykata Supreme pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë, të shprehur në aktgjykimet e tyre, përkizati me përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e tij qëndrojnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale mashtrim, i parashikuar me nenin 261 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ngase veprimet që ai i kishte ndërmarrë qartë kishin qëllim mashtrues në raport me të dëmtuarin [palen].”

Argumentet juridike të paraqitura nga parashtruesi

24. Parashtruesi pretendon se Gjykata e Qarkut në lidhje me ankesën, dhe Gjykata Supreme e Kosovës në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, kishin shkelur të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, siç garantohen me nenin 54 të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat duhet t'i shqyrtojnë dhe t'i vlerësojnë të gjitha provat e paraqitura nga palët, si dhe të përfshijnë arsyet në aktgjykimet e tyre, në mënyrën se si janë vlerësuar dëshmitë.
26. Parashtruesi pretendon se provat e reja që ai i ka paraqitur në Gjykatën e Qarkut, gjegjësisht kontrata me të bashkakuzuarin dhe deklarata e të bashkakuzuarit, ishin fakte vendimtare të reja, të cilat as Gjykata e Qarkut dhe as Gjykata Supreme nuk i morën parasysh në vendimet e tyre. Parashtruesi i kërkesës pohon se kjo përbën një mohim të drejtësisë.
27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës insiston se provat tregojnë se ai nuk kishte as synimin e qëllimshëm për të kryer mashtrim, dhe as nuk kishte fituar ndonjë përfitim material nga mashtrim i pretenduar, dhe se për këtë arsyet ai nuk ka mundur të shpallet fajtor për këtë vepër penale.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata vëren se parashtruesi pretendon shkeljen e së drejtës së tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tij, dhe ai citon nenet 32, 53 dhe 54 të Kushtetutës. Megjithatë, bazuar në thelbin e pretendimeve të tij, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në fakt ankohet për shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë këtë kërkesë sipas kësaj dispozite.
29. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi ka përbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.
30. Neni 113 i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme të kritereve ligjore që një kërkesë të jetë e pranueshme. Ajo parashevë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

31. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, gjithashtu përcakton se:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”*
32. Përveç kësaj, rregulli 36 (2) i Rregullores parashevë:
- “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]*
- (b) [...]faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; ose
[...], ose*
- (d) [...] kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.;”*

33. Në lidhje me këtë, në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese përsërit se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],

nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1)

34. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë se Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
35. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës ka mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe të kundërshtojë interpretimin e fakteve dhe të ligjit, të cilat ai i konsideron të padrejta, në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme. Gjykata vëren se teksti i vendimeve të Gjykatës së Qarkut në lidhje me ankesën e tij, dhe të Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, shprehimisht nuk përmendin pjesët e dëshmisë në të cilat parashtruesi e bazon kërkesën e tij. Megjithatë, Gjykata konstaton se vendimet e të dyja gjykatave janë të arsyetuara dhe në mënyrë adekuate i përgjigjen pretendimeve të parashtruesit në substancë.
36. Pas shqyrtimit të procedurave penale në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrale (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
37. Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjykatave, gjatë shqyrtimit të rastit, u mungonte paanshmëria ose që procedurat ishin në ndonjë mënyrë të padrejta. Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim i KEDNJ-së, Parashtresa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005.)
38. Bazuar në këto vlerësime, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk ka qenë viktimi e një mohimi të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të tij.
39. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e parashtruesit nuk kanë qenë të mbështetura me prova dhe duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara.
40. Rrjedhimisht, për arsyet e theksuara më lart, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113 (7) të Kushtetutës, nenit 46 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullat 36 (2) të Rregullores, më 12 shtator 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TA SHPALLË këtë vendim të plotfuqishëm menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani

